KUSHTET E SHËRBIMIT

Palet:

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): J91809007H (në vijim, "**SIGAL**") është një shoqeri sigurimesh e licensuar per te ushtruar aktivitetin me ..... që ofron te gjitha klasat e sigurimeve dhe si tipar te prodoktuve te saj, shton sherbimin e Platformes TeleDoc Albania Shpk. Një platformë burimesh e ndërtuar për të përmirësuar mirëqenien tuaj nëpërmjet një numri mjekësh, të cilët do të veprojnë në emër dhe për llogari të tyre, si mjekë të licencuar, në dhënien e këshillave përkatëse mjekësore në distancë.

TeleDoc Albania Shpk, me numër unik identifikimi të subjektit (NUIS): L91414028V (në vijim, "**TeleDoc**") nuk është një entitet që ofron sigurim shëndetësor dhe nuk zëvendëson mjekun tuaj të kujdesit shëndetësor parësor, por është një platformë burimesh e ndërtuar për të përmirësuar mirëqenien tuaj nëpërmjet një numri mjekësh, të cilët do të veprojnë në emër dhe për llogari të tyre, si mjekë të licencuar, në dhënien e këshillave përkatëse mjekësore në distancë.

Bien dakord per nje marreveshje bashkepunimi me karakter ekskluziv ne perputhje me kushtet e marreveshjes nr. Date

Megjithatë, në çdo rast, ndërveprimi juaj me mjekët – të cilët kontaktohen nëpërmjet platformës elektronike të TeleDoc – nuk ka për qëllim të zëvendësojnë marrëdhënien(et) tuaj(a) me mjekun(ët) tuaj, tek i cili/të cilët ndiqeni zakonisht apo qe mbulohen nga kontratat tuaja aktive te sigurimit.

Nëse gjendeni në kushtet e urgjencës mjekësore, ju lutemi të kontaktoni shërbimin e urgjencës mjekësore në numrin 127.

Ju rekomandojmë fuqimisht dhe kërkojmë të shqyrtoni me kujdes dhe kuptoni këto Kushte Shërbimi përpara se t'i pranoni ato dhe, rrjedhimisht, përpara se të përdorni shërbimet e parashikuara në to.

Duke pranuar, si dhe aderuar në, këto Kushte Shërbimi dhe/ose duke kërkuar shërbimet e parashikuara në to, ju pranoni dhe bini dakord që SIGAL dhe TeleDoc nuk mban asnjë përgjegjësi dhe/ose nuk ka asnjë detyrim të çfarëdo natyre qoftë, që mund të lindë në të ardhmen, nga ose në lidhje me këto shërbime, bazuar në argumentin dhe/ose faktin, si dhe/ose pretendimin, që ju nuk keni lexuar dhe/ose kuptuar këto Kushte Shërbimi.

1- PËRKUFIZIME

1.1 Në dispozitat e këtyre Kushteve të Shërbimit (siç përkufizohen më poshtë), përveç rasteve kur është e qartë nga konteksti, zbatohen përkufizimet e këtij Neni 1:

1.1.1 "Shërbimet e Telemjekësisë" – nënkupton të gjitha shërbimet shëndetësore në distancë dhe këshillimet shëndetësore nëpërmjet telefonit/videos, si dhe çdo shërbim të personalizuar në lidhje me shëndetin, të kërkuara nga Klienti.

Kanalet e komunikimit për qëllime të Shërbimeve të Telemjekësisë do të jenë përmes linjës së telefonit, internetit, aplikacionit celular dhe/ose aplikacionit për tablet të TeleDoc ("App") ;

1.1.2 "Ofrues i Kujdesit Shëndetësor" – nënkupton të gjithë mjekët e kujdesit shëndetësor, specialistët, si dhe/ose nën-specialistët, që ofrojnë Shërbimet e Telemjekësisë për Klientët, bazuar në parashikimet e këtyre Kushteve të Shërbimit dhe në marrëveshjet

përkatëse të shërbimit të lidhura midis Ofruesve të Kujdesit Shëndetësor dhe TeleDoc për këtë qëllim;

1.1.3 "Klient" – nënkupton individin që përfiton Shërbimet e Telemjekësisë sipas këtyre Kushteve Shërbimi, për veten e tij/saj dhe/ose pjesëtarët e familjes së tij/saj (plani familjar);

1.1.4 "Kushtet e Shërbimit"–nënkupton këtë dokument dhe dokumentet bashkëlidhur këtij;

1.1.5 "Tarifë" – nënkupton shumën vjetore në para që paguhet nga Klienti, për të përfituar Shërbimet e Telemjekësisë;

1.1.6 "Prim sigurimi" nwnkupton shumwn vjetore nw para qw paguhet nga i siguruari per tw pwrfituar njw kontratw sigurimi e cila pwrmban edhe shwrbimin e Teledoc

1.1.6 "Data e Hyrjes në Fuqi" – nënkupton datën e nënshkrimit, nga Klienti, të Deklaratës së Pëlqimit Paraprak sipas Aneksit 1 bashkëlidhur këtyre Kushteve Shërbimi;

1.1.7 "Periudhë Efektive" – nënkupton çdo periudhë 1 (një) vjeçare të këtyre Kushteve Shërbimi, duke filluar nga Data e Hyrjes në Fuqi të tyre deri nw datwn e pwrfundimit tw policws sw sigurimit;

1.1.8 "Kohëzgjatje" – nënkupton, së bashku, të gjitha Periudhat Efektive të këtyre Kushteve Shërbimi;

1.1.9 "Pala e Tretë Administruese" ose "PTA" – nënkupton subjektin nga i cili Klienti do blejë produktet e nevojshme për të përdorur Shërbimet e Telemjekësisë;

1.1.10 "Të Dhëna Mjekësore" – pa cenuar sa parashikohet ndryshme në këto Kushte Shërbimi, nënkupton informacionin personal shëndetësor që kërkohet për qëllime të mjekësisë parandaluese, diagnostikimit shëndetësor, ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësore, trajtimit ose menaxhimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësore, si dhe të dhënat që përdoren nga Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor dhe/ose persona të tjerë, të detyruar të ruajnë konfidencialitetin;

1.1.11 "Legjislacioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" – nënkupton ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar (në vijim, "Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"), si dhe aktet përkatëse nënligjore të qeverisë dhe/ose të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, "Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave") të nxjerra në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

1.2 Pa cenuar sa parashikohet në paragrafin 1.1 më sipër, të gjitha termat dhe/ose përkufizimet e përmendura në këto Kushte Shërbimi do kenë kuptimin që ju jepet në dispozitat përkatëse ose, në mungesë të një përkufizimi të caktuar, kuptimin që shërben për përmbushjen e objektit të këtyre Kushteve Shërbimi.

2- ZOTËSIA PËR TË VEPRUAR

Klienti deklaron dhe garanton se ai/ajo gëzon të drejtën ligjore dhe zotësinë e plotë juridike për të vepruar në emër të tij/saj dhe/ose të fëmijës së mitur, prind ose kujdestar i të cilit ai/ajo është dhe, në bazë të vullnetit të tij/saj të lirë, pranon, bie dakord, si dhe aderon në, dispozitat e këtyre Kushteve Shërbimi.

3- SHËRBIMET E TELEMJEKËSISË

3.1 Gjatë Kohëzgjatjes dhe në mënyrë jo-ekskluzive, TeleDoc i mundëson Klientit marrjen, nëpërmjet Ofruesve të Kujdesit Shëndetësor, e Shërbimeve të Telemjekësisë të kërkuara nga Klienti, për veten dhe/ose pjesëtarët e familjes së tij/saj (plani familjar).

3.2 TeleDoc ofron mbulim shëndetësor individët dhe familjet (plani familjar – 2 (dy) të rritur, 2 (dy) fëmijë deri në 25 (njëzet e pesë) vjeç).

3.3 Shërbimet e Telemjekësisë, nëpërmjet TeleDoc, do jenë të disponueshme 24 (njëzet e katër) orë në ditë, 7 (shtatë) ditë në javë, si dhe 365 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë) ditë në vit.

3.4 Shërbimet e Telemjekësisë mund të aksesohen si më poshtë:

3.4.1 Me anë të telefonit:

Klientët aksesojnë një numër të veçantë pa pagesë, që do të shfaqet në faqen e internetit të TeleDoc dhe/ose në çdo formë tjetër çfarëdo qoftë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, karta të veçanta, fletushka, etj. .

Kërkon marrjen e një vlerësimi mjekësor dhe një pyetësori mbi historikun shëndetësor, të plotësuar, për të krijuar një marrëdhënie mjek/pacient dhe për mjekimin që do të rekomandohet.

3.4.2 On-line:

(i) Video: Këshillim me anë të videos me Ofruesin e Kujdesit Shëndetësor, nëpërmjet sistemit të sigurt video të TeleDoc.

Kërkon marrjen e një vlerësimi mjekësor dhe një pyetësori mbi historikun shëndetësor, të plotësuar, për të krijuar një marrëdhënie mjek/pacient dhe për mjekimin që do të rekomandohet.

(ii) Nëpërmjet Hapësirës së bashkëbisedimit on-line (Chatroom): e disponueshme për Klientin për orë të caktuara (sipas orarit të pasqyruar në faqen e internetit të TeleDoc). Nëpërmjet hapësirës së bashkëbisedimit on-line (Chatroom) mund të adresohen tema dhe/ose çështje të ndryshme mjekësore.

4- DETYRIMET E PALËVE

4.1 Gjatë Kohëzgjatjes së këtyre Kushteve Shërbimi, TeleDoc do të:

4.1.1 mundësojë dërgimin dhe mbështetjen e Shërbimeve të Telemjekësisë që ofrohen nga Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor;

4.1.2 administrojë dhe mirëmbajë, në mënyrë të sigurt, një bazë të dhënash me informacione të profilizuara, të siguruara nga Klienti, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, përfshirë, por pa u kufizuar, Legjislacionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

4.2 Gjatë kohëzgjatjes së Kushteve të Shërbimit, Klienti do të:

4.2.1 dorëzojë tek TeleDoc, ose PTA e përcaktuar nga kjo e fundit, informacionin e regjistrimit;

4.2.2 kryejë të gjitha pagesat përkatëse ndaj TeleDoc;

4.2.3 përdorë Shërbimet e Telemjekësisë në përputhje me këto Kushte Shërbimi.

5- ÇMIMI DHE PAGESA

5.1 Klienti paguan tarifën ose pwrfiton Falas nwpwrmjet produkteve tw sigurimit tw ofruara nga SIGAL për përdorimin e Shërbimeve të Telemjekësisë.

5.2 SIGAL ruan të drejtën të ndryshojë Tarifën për çdo Periudhë Efektive të ardhshme, duke njoftuar Klientin me shkrim, të paktën, 10 (dhjetë) ditë përpara përfundimit të Periudhës Efektive përkatëse.

5.3 Përveç kur parashikohet ndryshe nga dispozitat e këtyre Kushteve Shërbimi, Klienti pranon dhe bie dakord që shumat që i paguhen, nga ky i fundit, SIGAL të përcaktuar prej kësaj të fundit, janë pa të drejtë kompensimi, zbritjeje ose pretendimi tjetër.

6- KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI

6.1 Përveçse kur parashikohet ndryshe në këto Kushte Shërbimi, këto të fundit do të jenë në fuqi deri në 1 (një) vit deri nw datwn e pwrfundimit tw policws pwrkatwse, si dhe ripërtërihen, në mënyrë aktive/automatike, për periudha të tjera 1 (një) vjeçare shtesë, në çdo përvjetor të Datës së Hyrjes në Fuqi.

6.2 Secila palë mund t'i zgjidhë këto Kushte Shërbimi, në çdo kohë, duke njoftuar palën tjetër, me shkrim, të paktën 30 (tridhjetë) ditë paraprakisht. Në rast zgjidhjeje të parakohshme të këtyre Kushteve Shërbimi, për çfarëdo arsye që nuk lidhet me veprimet dhe/ose mosveprimet e TeleDoc, zbatohen dispozitat e paragrafit 5.4 të Nenit 5 më sipër.

7- PRONËSIA INTELEKTUALE

7.1 Të gjitha të drejtat mbi emrat e produkteve, emrat e shoqërisë, emrat tregtarë, logot, sllloganet, paketimin e produktit dhe disenjot e Shërbimeve të Telemjekësisë, pavarësisht nëse paraqiten ose jo me shkronja të mëdha apo me simbole të markës tregtare, i përkasin ekskluzivisht TeleDoc ose subjekteve licencuese të tij, si dhe mbrohen nga riprodhimi, imitimi, pakësimi ose përdorimet ngatërruese ose çorientuese, sipas legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për pronësinë industriale dhe të drejtën e autorit.

7.2 Përdorimi ose keqpërdorimi i këtyre markave tregtare ose çfarëdo materiali, përveçse kur autorizohet këtu, është shprehimisht i ndaluar dhe asgjë e deklaruar apo nënkuptuar në Shërbimet e Telemjekësisë nuk i jep Klientit asnjë licencë ose të drejtë të parashikuar në patentat apo markat tregtare të TeleDoc, të subjekteve të lidhura me të, të ndonjë pale të tretë.

7.3 Klienti nuk do të publikojë, riprodhojë, shpërndajë, shfaqë, kryejë, redaktojë, përshtasë, modifikojë, ose shfrytëzojë në çfarëdo forme tjetër, asnjë pjesë të Shërbimeve të Telemjekësisë, pa pëlqimin me shkrim të TeleDoc.

8- MBROJTJA E TË DHËNAVE

8.1 Klienti pranon, kupton dhe bie dakord që, për qëllime të marrjes së Shërbimeve të Telemjekësisë, t'i japë të dhënat e tij/saj personale, si dhe të Dhënat Mjekësore, Ofruesit përkatës të Kujdesit Shëndetësor. Klienti pranon, kupton dhe bie dakord që përpunimi i të dhënave të tij/saj personale kryhet në bazë vullnetare, por, gjithsesi, ky përpunim do kryhet gjithashtu në përputhje me dispozitat e Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale që përcakton detyrimet, e subjektit kontrollues, për raportim dhe për ruajtjen e të dhënave. TeleDoc do të veprojë në cilësinë e subjektit kontrollues të të dhënave personale, të cilat do të përpunohen nga Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor dhe personeli tjetër administrativ i TeleDoc.

8.2 Përveç sa parashikohet në paragrafin 8.1 më sipër, Klienti pranon, kupton dhe bie dakord me sa

më poshtë vijon:

8.2.1 Shërbimet e Telemjekësisë përfshijnë komunikimin elektronik të të dhënave personale dhe të Dhënave Mjekësore të tij/saj;

8.2.2 përpunimi (përfshirë, por pa u kufizuar në, mbledhjen, organizimin, mbajtjen, transmetimin, etj.) i të dhënave personale dhe/ose të Dhënave Mjekësore të tij/saj do të kryhet në përputhje të plotë me Legjislacionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

8.2.3 të Dhënat Mjekësore do të përpunohen, kryesisht, nga Ofruesi përkatës i Kujdesit Shëndetësor, i cili do të regjistrojë vetëm të Dhënat Mjekësore të nevojshme dhe do të krijojë dosje personale për çdo pacient, të cilat do të ruhen në sistemin e TeleDoc për periudhat e përcaktuara në Kreun III (Mbajtja e të Dhënave Personale) të Udhëzimit nr. 23, datë 20.11.2012, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave "Për përpunimin e të dhënave personale në sektorin e shëndetësisë" (në vijim referuar si "**Udhëzimi nr. 23**");

8.2.4 të Dhënat Mjekësore përmbajnë informacione të tilla si, përfshirë, por pa u kufizuar, historikun mjekësor, gjendjen aktuale shëndetësore të Klientit dhe/ose të pjesëtarëve të familjes së tij/saj (plani familjar), etj.;

8.2.5 përpunimi i të dhënave personale dhe të Dhënave Mjekësore do të kryhet vetëm për qëllime të ofrimit të Shërbimeve Telemjekësore nga ana e Ofruesve të Kujdesit Shëndetësor, këshillimi i të cilëve përfshin, por pa u kufizuar, mjekësinë parandaluese, diagnostikimin shëndetësor, ofrimin e kujdesit shëndetësor, trajtimin dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

8.2.6 TeleDoc do të mbajë dhe ruajë të dhënat personale dhe të Dhënat Mjekësore në një bazë të dhënash elektronike të veçantë dhe të sigurt, në përputhje me dispozitat e Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, siç përcaktohet, ndër të tjera, në nënparagrafin 8.2.3 më sipër. Për këtë qëllim, TeleDoc garanton një sistem të sigurt për mbledhjen dhe përpunimin e të Dhënave Mjekësore.

8.2.7 me iniciativë të TeleDoc dhe/ose me kërkesë të Klientit, TeleDoc do të kryejë bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale dhe të Dhënave Mjekësore, kur konstaton se të dhënat personale dhe/ose të Dhënat Mjekësore janë të pasakta, të pavërteta dhe të paplota, si dhe/ose janë përpunuar në shkelje të dispozitave të Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

8.3 Pa cenuar sa parashikohet në këto Kushte Shërbimi dhe/ose dispozitat e Legjislacionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Klienti gëzon, gjithashtu, edhe të drejtat e mëposhtëme:

8.3.1 të pajiset me një kopje të të dhënave personale dhe të Dhënave Mjekësore të tij/saj, të mbajtura nga TeleDoc;

8.3.2 të kërkojë akses dhe/ose korrigjimin, bllokimin, fshirjen e të dhënave personale dhe/ose të Dhënave Mjekësore të tij/saj, si dhe të tërheqë pëlqimin e dhënë për përpunimin e mëtejshëm të këtyre të dhënave dhe/ose të kërkojë kufizimin dhe/ose të kundërshtojë përpunimin e mëtejshëm të tyre. Për këtë qëllim, TeleDoc do t'i përgjigjet dhe do të adresojë kërkesat e Klientit brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike, siç parashikohet në Legjislacionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Klienti do të adresojë kërkesën e tij/saj në formën e përcaktuar në Nenin 13 të këtyre Kushteve Shërbimi.

8.4 Klienti jep pëlqimin e tij/saj, për TeleDoc, për transmetimin e të dhënave personale dhe të

Dhënave Mjekësore të tij/saj tek palë të treta, brenda dhe/ose jashtë Shqipërisë, për aq sa është e nevojshme për përmbushjen e duhur të Shërbimeve të Telemjekësisë, por, në çdo rast, në përputhje me, por pa u kufizuar, në nenin 7 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Udhëzimin nr. 23 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave.

8.5 Parashikimet e këtij Neni 8 të këtyre Kushteve Shërbimi duhet të lexohen dhe interpretohen në përputhje me Legjislacionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe për çdo çështje që nuk është adresuar këtu, do të zbatohen parashikimet e këtij legjislacioni.

Këto Kushte Shërbimi nuk kanë për qëllim të kufizojnë dhe/ose pakësojnë të drejtat e Klientit si subjekt të dhënash dhe as të kufizojnë dhe/ose pakësojnë detyrimet e TeleDoc si subjekt kontrollues të dhënash, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe/ose të të Dhënave Mjekësore, por synojnë të sigurojnë dhe konfirmojnë angazhimin e TeleDoc për të vepruar, në çdo kohë, në përputhje me Legjislacionin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

9- DEKLARIME DHE GARANCI

9.1 TeleDoc deklaron dhe garanton Klientin se do të respektojë dhe veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në lidhje me çfarëdo informacioni personal mjekësor që Klienti i ka dhënë TeleDoc;

9.2 TeleDoc nuk jep asnjë garanci, përfaqësim apo sigurim, qoftë të shprehur apo të nënkuptuar, sa i përket kualifikimeve profesionale, ekspertizës, cilësisë së punës, aftësive etj., të Ofruesve të Kujdesit Mjekësor dhe/ose sa i përket çdo kapaciteti/përmbajtjeje tjetër në lidhje me Shërbimet e Telemjekësisë që kryhen nga Ofruesit e Kujdesit Mjekësor. TeleDoc nuk mban përgjegjësi, në asnjë rast, kundrejt Klientit dhe/ose çdokujt tjetër, për vendimet e marra dhe/ose veprimet e kryera duke u mbështetur në sa parashikuar këtu;

9.3 TeleDoc në asnjë mënyrë nuk këshillon dhe/ose rekomandon ndonjë Ofrues të veçantë të Kujdesit Shëndetësor të listuar dhe/ose të aksesueshëm nëpërmjet platformës së Shërbimeve të Telemjekësisë. Klienti është i vetëdijshëm dhe pranon se Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor që ofrojnë Shërbimet e Telemjekësisë janë ofrues të pavarur të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, jo punëmarrës të TeleDoc. TeleDoc vetëm lehtëson komunikimin midis Ofruesve të Kujdesit Shëndetësor dhe Klientit përmes platformës së TeleDoc për qëllime të ofrimit të Shërbimeve të Telemjekësisë;

9.4 TeleDoc nuk garanton asnjë veprim ose ofrim të pandërprerë apo pa gabime të Shërbimeve të Telemjekësisë. Të gjitha informacionet, materialet dhe shërbimet i ofrohen Klientit "SIÇJANË".

9.5 Përveçse kur parashikohet shprehimisht në këto Kushte Shërbimi, TeleDoc mohon të gjitha deklarimet dhe garancitë, të shprehura apo të nënkuptuara, duke përfshirë, por pa u kufizuar, garancitë për funksionimin e shërbimit, për përshtatshmërinë e shërbimit për qëllimin e posaçëm të tij dhe për moscenimin e të drejtave përkatëse.

9.6 Pa cenuar sa parashikohet në paragrafët 9.1 deri 9.5 të këtij Neni 9, Klienti pranon, kupton dhe bie dakord që:

9.6.1 Ofruesit e Kujdesit Shëndetësor nuk do të trajtojnë gjendje të rënda dhe/ose urgjenca shëndetësore si pjesë e Shërbimeve të Telemjekësisë dhe mund t'i rekomandojnë Klientit të vizitohet tek mjeku i tij/saj i kujdesit shëndetësor parësor, specialistë dhe/ose qendra shëndetësore lokale, nëse konsiderohet e nevojshme, në gjykimin e plotë dhe absolut të tyre;

9.6.2 kur Klienti jep paraprakisht pëlqim me shkrim, mjekët që ofrojnë shërbimet në lidhje me Shërbimet e Telemjekësisë do të mbështesin vijimësinë e kujdesit shëndetësor;

9.6.3 SIGAL wshtw e pwrjashtuar nga cdo pwrgjegjwsi pwr shwrbimet e Teledoc, kualifikimeve profesionale, ekspertizës, cilësisë së punës, aftësive etj, të Ofruesve të Kujdesit Mjekësor dhe/ose sa i përket çdo kapaciteti/përmbajtjeje tjetër në lidhje me Shërbimet e Telemjekësisë që kryhen nga Ofruesit e Kujdesit Mjekësor si dhe pasojat qw mund ti vijnw klientit si rezultat i kwtyre shwrbimeve.

9.6.4 ai/ajo ka dijeni për rreziqet e mundshme të Shërbimeve të Telemjekësisë siç janë, por pa u kufizuar:

(i) vonesa në vlerësimin mjekësor dhe konsultim apo trajtim, që mund të ndodhin si rezultat i mangësive apo dështimeve të pajisjeve dhe që mund të përfshijnë cilësi të dobët të videove dhe të të dhënave;

(ii) protokollet e sigurisë mund të dështojnë, duke shkaktuar cënim të konfidencialitetit të të Dhënave Mjekësore;

(iii) mungesa e aksesit në të Dhëna Mjekësore të plota mund të rezultojë në reaksione të rënda alergjike ose rezultate të tjera negative.

9.7 Secila palë deklaron dhe i garanton palës tjetër që:

9.7.1 ka të drejtë, fuqi dhe autoritet të plotë për të nënshkruar dhe vepruar në përputhje me këto Kushte Shërbimi; dhe

9.7.2 këto Kushte Shërbimi përbëjnë një detyrim të vlefshëm dhe detyrues për palën në fjalë, të zbatueshme kundrejt saj në përputhje me dispozitat përkatëse, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm për falimentin, paaftësinë paguese, riorganizimin dhe çdo legjislacion tjetër të zbatueshëm që rregullon të drejtat e kreditorëve në përgjithësi.

10- SJELLJE TË NDALUARA

10.1 Klienti nuk do të aksesojë ose përdorë dhe/ose nuk do të tentojë të aksesojë ose përdorë Shërbimet e Telemjekësisë, si dhe/ose ndërmarrë ndonjë veprim, në shkelje të parashikimeve të këtyre Kushteve Shërbimi dhe/ose në çfarëdo mënyre që mund të dëmtojë TeleDoc dhe/ose ndonjë palë të tretë, ndërhyjë në funksionimin e Shërbimeve të Telemjekësisë, si dhe/ose të përdorë Shërbimet e Telemjekësisë në shkelje të legjislacionit shqiptar në fuqi.

Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar, Klienti nuk do të:

10.1.1 regjistrojë Ofruesin e Kujdesit Shëndetësor gjatë dhënies së Shërbimeve të Telemjekësisë, pa pëlqim paraprak të këtij të fundit;

10.1.2 transmetojë asnjë mesazh dhe/ose informacion nën emër të rremë;

10.1.3 ndërpresë ose tentojë të ndërpresë funksionimin e Shërbimeve të Telemjekësisë nëpërmjet çfarëdolloj mënyre;

10.1.4 përdorë Shërbimet e Telemjekësisë në një mënyrë të tillë që mund t'i dëmtojë, ndërpresë dhe/ose dobësojë ato;

10.1.5 përfitojë, ose tentojë të përfitojë, akses të paautorizuar në asnjë informacion;

10.1.6 japë informacion të gabuar, të pasaktë, jo aktual, të paplotë, të paligjshëm, diskreditues, mashtrues, ngacmues, kërcënues ose me përmbajtje urrejtjeje;

10.1.7 përdorë asnjë pajisje dhe/ose program kompjuterik për të ndërhyrë, ose për të tentuar të ndërhyjë, në funksionimin e rregullt të Shërbimeve të Telemjekësisë dhe/ose ndonjë aktivitet të zhvilluar në kuadër të Shërbimeve të Telemjekësisë dhe/ose tentojë të hetojë, skanojë, testojë dobësitë dhe/ose të shkelë sigurinë e ndonjë sistemi të TeleDoc;

10.1.8 angazhohet në asnjë sjellje që i kufizon dhe/ose i ndalon ndonjë personi përdorimin e Shërbimeve të Telemjekësisë, ose që, sipas gjykimit të vetëm të TeleDoc, ekspozon TeleDoc dhe/ose ndonjë përdorues të tij, subjekt të lidhur me TeleDoc dhe/ose ndonjë palë të tretë, ndaj çfarëdo përgjegjësie apo dëmesh të çfarëdo lloji qofshin.

10.2 Në përputhje me Nenin 10.1 më sipër, TeleDoc do të pezullojë ose ndërpresë aksesin në Shërbimet e Telemjekësisë për çfarëdo arsye, në çdo kohë, pa njoftuar. Në këtë rast, zbatohen parashikimet e paragrafit 5.4 të Nenit 5.

11-KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË

11.1 Për aq sa lejohet nga legjislacioni i zbatueshëm, asnjë palë nuk do të jetë përgjegjëse ndaj palës tjetër dhe/ose ndonjë pale të tretë për asnjë humbje, dëm ose shpenzim rezultues, të veçantë, jo të drejtpërdrejtë, rastësor, penalizues apo ndëshkues, të shkaktuar nga, ose në lidhje me, këto Kushte Shërbimi dhe/ose Shërbimet e Telemjekësisë.

11.2 Klienti pranon dhe bie dakord që përgjegjësia totale e TeleDoc ndaj Klientit për çfarëdo lloj dëmi, humbjeje, tarife, pagese, shpenzimi dhe/ose përgjegjësie të shkaktuar nga/ose në lidhje me këto Kushte Shërbimi dhe/ose Shërbimet e Telemjekësisë nuk tejkalon vlerën e Tarifës së paguar nga Klienti për 1 (një) Periudhë Efektive përpara vërtetimit të dëmeve, humbjeve, tarifave, pagesave, shpenzimeve dhe/ose përgjegjësive përkatëse.

11.3 As TeleDoc dhe asnjë licencues i saj, furnizues dhe/ose ndonjë palë e tretë që promovon Shërbimet e Telemjekësisë, nuk mban përgjegjësi për asnjë këshillë profesionale që Klienti merr nga Ofruesi i Kujdesit Shëndetësor dhe as për ndonjë informacion të marrë nëpërmjet Shërbimeve të Telemjekësisë. Klienti pranon, kupton dhe bie dakord që mbështetja e tij/saj në këshillat e Ofruesit të Kujdesit Shëndetësor dhe/ose informacionin e dhënë nëpërmjet Shërbimeve të Telemjekësisë është përgjegjësi e vetme të tij/saj dhe ai/ajo merr përsipër përgjegjësi të plotë për të gjitha risqet e lidhura me të.

11.4 TeleDoc, licencuesit e tij, furnizuesit dhe/ose të gjitha palët e treta që promovojnë Shërbimet e Telemjekësisë mohojnë shprehimisht çdo përgjegjësi që rezulton nga dhënia e Shërbimeve të Telemjekësisë, përfshirë, por pa u kufizuar, përgjegjësinë për trajtimin e gabuar mjekësor nga ana e Ofruesve të Kujdesit Shëndetësor.

12- DËMSHPËRBLIMI

12.1 Secila palë (secila, në vijim referuar si "Pala Dëmshpërblyese") bie dakord të mbrojë, dëmshpërblejë dhe ruajë të pacenuar palën tjetër dhe zotëruesit, zyrtarët, drejtuesit, punëmarrësit, kontraktorët, përfaqësuesit, agjentët dhe subjektet e lidhura të palës tjetër (në vijim, së bashku referuar si "Palët e Çliruara nga Përgjegjësia" dhe veçmas si "Pala e Çliruar nga Përgjegjësia") ndaj çdo pretendimi të çdo pale të tretë, të shkaktuar nga dhe/ose në lidhje me ndonjë shkelje të këtyre Kushteve Shërbimi nga Pala e Çliruar nga Përgjegjësia, përfshirë, por pa u kufizuar, shkelje të çfarëdo deklarate, garancie, marrëveshjeje, ose detyrimi sipas këtyre Kushteve Shërbimi.

12.2 Pala e Çliruar nga Përgjegjësia do të njoftojë menjëherë Palën Dëmshpërblyese me shkrim për çdo pretendim dhe do të bashkëpunojë me Palën Dëmshpërblyese në mënyrë të arsyeshme në mbrojtjen përkatëse kundër këtij pretendimi.

13- NJOFTIMET

13.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet e tjera të kërkuara dhe/ose të ofruara sipas këtyre Kushteve Shërbimi do të jenë me shkrim.

13.2 Në përputhje me paragrafin 13.1 më sipër, njoftimet dhe komunikimet do të dorëzohen si më poshtë:

13.2.1 Për TeleDoc:

Nëadresën: Rruga "Abdyl Frashëri, Hekla Centre Shk.C Ap.3

E-mail: info@teledoc.al

13.2.2 Për Klientin: në adresën e plotësuar në Deklaratën e Pëlqimit Paraprak, bashkëlidhur

në Aneksin 1 të këtyre Kushteve Shërbimi.

14- ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

14.1 Përveçse kur parashikohet ndryshe në këto Kushte Shërbimi, TeleDoc dhe Klienti bien dakord të zgjidhin çdo mosmarrëveshje të shkaktuar nga ose dhe/ose në lidhje me dispozitat e këtyre Kushteve Shërbimi dhe/ose Shërbimet e Telemjekësisë, sipas parashikimeve të këtij Neni 14, si më poshtë:

14.1.1 Zgjidhja e Miqësore:

Të gjitha mosmarrëveshjet ju paraqiten, fillimisht, përfaqësuesve të autorizuar të palëve për diskutimin dhe zgjidhjen e tyre (në vijim "Zgjidhja Miqësore");

14.1.2 Gjykata kompetente:

Nëse nuk arrihet Zgjidhja Miqësore e mosmarrëveshjeve, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike pas datës së kërkesës së parë të cilësdo palë, atëherë secila palë mund t'i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

14.2 Këto Kushte Shërbimi rregullohen dhe interpretohen në përputhje me ligjet e Shqipërisë.

14.3 Secila palë pranon dhe bie dakord që shkelja e këtyre Kushteve Shërbimi mund të shkaktojë cenim me pasoja të pakorrigjueshme ndaj palës tjetër, për të cilin dëmet financiare mund të jenë të vështira për t'u përcaktuar, apo mjetet ligjore të papërshtatshme. Prandaj, secila palë, përveç të drejtave dhe mjeteve ligjore të tjera, ka të drejtë të kërkojë dhe përfitojë masa sigurimi padie për çdo shkelje të këtyre Kushteve Shërbimi, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

14.4 Të drejtat dhe mjetet ligjore të parashikuara në këto Kushte Shërbimi janë kumulative dhe të njëkohshme, si dhe mund të zbatohen veçmas, njëra-pas-tjetrës ose së bashku.

15- TË NDRYSHME

15.1 Këto Kushte Shërbimi përbëjnë marrëveshjen e plotë midis TeleDoc dhe Klientit dhe zëvendësojnë çdo dakordësi dhe/ose marrëveshje, me shkrim dhe/ose me gojë, të mëparshme midis TeleDoc dhe Klientit.

15.2 Asnjë heqje dorë ndaj ndonjë shkelje të ndonjë dispozite të këtyre Kushteve Shërbimi, nga cilado palë, nuk do të interpretohet si heqje dorë ndaj ndonjë shkelje e mëvonshme e së njëjtës dispozitë apo të ndonjë dispozite tjetër.

15.3 Pavlefshmëria e ndonjë dispozite të këtyre Kushteve Shërbimi nuk ndikon në zbatueshmërinë e dispozitave të mbetura dhe/ose çfarëdo dispozite tjetër. Të gjitha anekset, shtojcat dhe skedulet e këtyre Kushteve Shërbimi janë të vërteta, të sakta dhe të përfshira në to nëpërmjet referencave përkatëse, si dhe përbëjnë pjesë integrale të këtyre Kushteve Shërbimi.

15.4 Këto Kushte Shërbimi janë detyruese, prodhojnë efekte dhe janë të zbatueshme nga TeleDoc dhe Klienti, si dhe pasardhësit dhe personat pasues të tyre. Këto Kushte Shërbimi nuk interpretohen në mënyrë të tillë që t'i japin çfarëdo personi tjetër, përveç TeleDoc dhe/ose Klientit, çfarëdo të drejte ligjore dhe/ose të ngjashme, mjet ligjor apo pretendim të parashikuar nga, apo në lidhje me, këto Kushte Shërbimi.

15.5 Këto Kushte Shërbimi nuk krijojnë shoqëri të thjeshtë, ortakëri apo marrëdhënie tjetër formale biznesi dhe/ose ndonjë entitet të çfarëdo lloji, apo ndonjë detyrim për të formuar ndonjë marrëdhënie dhe/ose entitet të tillë. Secila palë vepron si subjekt i pavarur dhe asnjë prej tyre nuk do të veprojë si agjent i palës tjetër për asnjë lloj qëllimi, si dhe as nuk e ka autoritetin për detyruar palën tjetër në lidhje me këtë aspekt.

15.6 Pa cenuar sa parashikohet ndryshe në paragrafin 5.3 të Nenit 5 të këtyre Kushteve Shërbimi, TeleDoc ruan të drejtën të ndryshojë dispozitat e parashikuara këtu, për çdo Periudhë Efektive të ardhshme, pas njoftimit me shkrim të Klientit të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara përfundimit të Periudhës Efektive të përkatëse.

15.7 Këto Kushte Shërbimi hartohen në 2 (dy) kopje, nga 1 (një) për secilën palë, në gjuhën shqipe.

***

Aneksi 1

DEKLARATA E PËLQIMIT PARAPRAK

Data: _____

Emri: _____

Mbiemri: _____

Datëlindja: _____

Gjinia: _____

Numri personal i identifikimit: _____

Adresa: _____

E-mail: _____

Nëpërmjet këtij dokumenti, deklaroj dhe garantoj, me vullnetin tim të lirë dhe duke qenë plotësisht i vetëdijshëm për pasojat ligjore përkatëse, se kam lexuar dhe kuptuar informacionin e treguar në dispozitat e këtyre Kushteve Shërbimi, si dhe kuptoj dhe jam plotësisht i vetëdijshëm për rreziqet dhe/ose përfitimet e Shërbimeve të Telemjekësisë.

Nëpërmjet këtij dokumenti, pranoj, bie dakord dhe aderoj në këto Kushte Shërbimi.

Nëpërmjet këtij dokumenti, jap pëlqimin tim të plotë dhe paraprak, për TeleDoc, për përpunimin e të dhënave të mia personale dhe të Dhënave Mjekësore në përputhje me Nenin 8 të këtyre Kushteve Shërbimi. Jam plotësisht i vetëdijshëm për të drejtat e mia në lidhje me përpunimin e të dhënave të mia personale dhe të Dhënave Mjekësore, përfshirë, por pa u kufizuar, të drejtën për të kërkuar korrigjimin, bllokimin, fshirjen e tyre, si dhe të drejtën për të tërhequr pëlqimin tim për përpunimin e mëtejshëm të tyre, në çdo kohë, në përputhje me dispozitat e Nenit 8 të këtyre Kushteve Shërbimi.

Nëpërmjet këtij dokumenti, jap pëlqimin tim paraprak për përdorimin e Shërbimeve të Telemjekësisë sipas dispozitave të këtyre Kushteve Shërbimi.

Pa cenuar sa deklaruar më sipër, pranoj dhe bie dakord në përputhje me nenin 686 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht, bashkërisht dhe veçmas (por pa u kufizuar në lidhje me dispozitat e tjera të këtyre Kushteve Shërbimi), me paragrafin 5.4 të Nenit 5, paragrafin 6.2 të Nenit 6, Nenin 9, Nenin 10, Nenin 11, Nenin 12 dhe paragrafin 15.6 të Nenit 15 të këtyre Kushteve Shërbimi.

_____

[emër, mbiemër, nënshkrim